Mora një kopje
Milazim KABASHI
[signature]
Dt. 25.07.2008

-50-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN – BUNE**

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

**Nr.** 360 **Prot.** **Shkoder,dt.** 25.07. **2008**

## I N F O R M A C I O N

### "MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI I HITHIT DHE ZHAUREVE FSHATI FLET H/C FLET 1 PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SUBJEKTI " ADNAIN "

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga subjekti " ADNAIN "per perdorim te burimit ujor Perroi i Hithit dhe Zhaureve per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm, veprat e marrjes se ujit ne Perroin e Hithit dhe Zhaureve do te ndertohen respektivisht ne kuotat 788 m dhe 784 m mbi nivelin e detit. Ndertesa e centralit do te ndertohet ne afersi te fshatit Flet ne kuoten 480 m mbi nivelin e detit. Prurja mesatare shum vjecare ne akset e veprave te marrjes eshte Q= 0.9 m3/sek..Subjekti kerkon te shfrytezoje nje prurje Q= 0.8 m3/sek.

Subjekti gjate periudhes se veres nuk do pengoje vaditjen.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 "PER KONCESIONET ", dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 87, dt. 16.01.2008, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007, te K.M., "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve", te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES**
**DRIN-BUNE**

**SEKRETARI**
[signature]
**Ing. Osman DELTINA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KESHILLI KOMBETAR I UJIT - KESHILLI I BASENIT DRIN-BUNE

**K R Y E T A R I**
[signature]
**Maxhid CUNGU**